



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 218, Datë 13.12.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 178, datë 18.11.2022, e z. E.P., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, të nxënësit E.R., nga ana e një grupi prindërisht të nxënësve të klasës IV-C, pranë Shkollës 9 vjeçare “Qemal Mici”, Durrës, si dhe mësueses së kësaj klase, znj. O.S.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban ankesa, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesi E.P. është drejtor i Shkollës 9 vjeçare “Qemal Mici”, Durrës. Ankuesi parashtroi ankesën e tij, për nxënësin E.R., i cili vuan nga autizmi, duke pretenduar se ky nxënës është diskriminuar nga prindërit e nxënësve të klasës IV-C dhe nga mësuesja e kësaj klase, znj. O.S. Për sa më sipër, ankuesi deklaroi se grupi i prindërve dhe mësuesja kanë bojkotuar mësimin për disa ditë rresht, përkatësisht nga data 03.10.2022 deri në datën 14.10.2022. Mësuesja e kësaj klase ka refuzuar të mbajë në klasë dhe të bëjë mësim me nxënësin me aftësi të kufizuara E.R.. Nxënësi në fjalë, fillimisht, nuk asistojë nga një mësuese ndihmëse, e cila i është vënë në dispozicion në datën 20.09.2022.

Në vijim, ankuesi pretendon se grupi i prindërve dhe mësuesja O.S. e kanë bërë çështjen mediatike dhe kanë kërkuar largimin e fëmijës me aftësi të kufizuara nga klasa VI-C. Drejtori i

shkollës sqaron se mësuesja O.S. është bërë palë me grupin e prindërve, duke mos i sqaruar ata se të drejtën për arsim e ka çdo fëmijë, pavarësisht aftësisë së tij.

Në datën 30.09.2022, në drejtorinë e shkollës janë paraqitur disa prindër të drejtuar nga Kryetari i Këshillit të prindërve të klasës, z. SH.SH., me kërkesën ultimative për largimin e nxënësit E.R. nga shkolla, me pretendimin se gjatë vitit të kaluar shkollor ka ushtruar dhunë fizike mbi nxënësit e tjerë të klasës. Prindërit kanë insistuar në kërkesën e tyre duke ushtruar presion se do të largonin fëmijët e tyre nga shkolla. Titullari i institucionit arsimor sqaron se mësuesja O.S. ka qenë dakord me qendrimin e prindërve dhe i ka mbështetur ata në lidhje me këtë kërkesë.

Drejtori i shkollës shprehet se çështja në fjalë është shqyrtuar nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, i cili ia ka kaluar çështjen për trajtim Komisionit të Disiplinës së Shkollës 9-vjeçare “Qemal Mici”, Durrës. Ky Komision ka marrë masën disiplinore “qortim” për mësuesen O.S., ndërkohë që drejtorja e shkollës mori masa për sistemimin e nxënësit me aftësi të kufizuara në një klasë tjetër, ku u gjet mirëkuptimi i prindërve të nxënësve të kësaj klase dhe prindërve të nxënësit E.R..

Drejtori i shkollës thekson faktin se edhe pse kjo nuk ishte mënyra më e mirë për të zgjidhur çështjen në fjalë, u detyruan që për efekt të vijimit normal të mësimit të arrinin në këtë zgjidhje. Ndër të tjera, z. E.P. e informon KMD-në se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar materialin kallëzues nr. 3510 ndaj fëmijës me aftësi të kufizuara E.R., për veprën penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal dhe me shkresën nr. 4418 prot., datë 04.11.2022, ka kërkuar dokumentacionin që disponon Shkolla 9-vjeçare “Qemal Mici”, Durrës, në lidhje me rastin konkret.

Për sa më sipër, z. E.P. kërkon shqyrtimin e kësaj çështjeje nga KMD me qëllim që të minimizohet diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, sidomos në rastin e një mësueseje që nuk komunikon me prindërit e tjerë dhe nuk i informon ata që e drejta për arsim është e vlefshme edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. Z. E.P. kërkon nga KMD marjen e masave maksimale që parashikon ligji për prindërit dhe mësuesen O.S., që organizuan bojkotin e mësimit në klasën e IV-C.

Pas analizimit paraprak të ankesës, Komisioneri çmoi se :

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

a)

b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitimit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm çënohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në nenin 32, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikohet shprehimisht se:

“1.Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

d).....”

Referuar parashikimit të gërmës a), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar. Në këtë kontekst, diskriminimi i pretenduar duhet t’i ketë ndodhur personit, i cili ndodhet në cilësinë e ankuesit, ose duke iu referuar gërmës b), të pikës 1 të nenit 32, një

organizatë me interesa legjitime, mund të përfaqësojë individin pranë Komisionerit, nëpërmjet një akti përfaqësimi.

Në rastin konkret, z. E.P., në cilësinë e titullarit të institucionit arsimor ankohet për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar të nxënësit E.R., nga ana e një grupi prindërisht dhe mësueses së klasës IV-C të Shkollës 9-vjeçare “Qemal Mici”, Durrës. Pavarësisht pozicionit të tij, Komisioneri gjykon se ai nuk legjitimohet në ankesën e tij, ankesë, të cilën duhej ta paraqesin vetëm prindërit e fëmijës, të cilët janë kujdestarët ligjorë të nxënësit E.R. dhe mbrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e fëmijës së tyre.

Në këtë kontekst, në referencë të nenit 33, pika 4, gërma b), ku parashikohet: *“Ankesa nuk pranohet kur:b)..... ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”* Komisioneri gjykon se kjo ankesë është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 44, pika 2, 65, gërma b) dhe 128, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe nenet 1, 4, 7, pika 1, nenet 17, 21, pika 1, 32, pika 1, gërma a) dhe 33, pika 4, gërma b), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

V E N D O S I :

1. Mospranim të ankesës nr. 178, datë 18.11.2022, së z. E.P., pasi ai nuk legjitimohet për kryerjen e kësaj ankese pranë Komisionerit.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Arsim
Shkak – aftësi e kufizuar
Lloji i vendimit - mospranim

